



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300959/9

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda :** *Sugjerohet publikimi i të dhënave të plota dhe të detajuara sa i përket identitetit të pakicave kombëtare duke identifikuar çdo ndryshim në raport me CENS-et e mëparshme, për të ndihmuar kuptueshmërinë e të dhënave dhe nxitur besimin nga publiku i gjerë*

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

**Për dijëni:** **ALEANCËS SË MAQEDONASVE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN**  
Fshati Pustec, Bashkia Pustec, Tel: 0672046050

Të nderuar,

Siç jeni në dijëni, pranë institucionit të Avokatit të Popullit është administruar me letra e Aleancës së Maqedonasve për Integrimin Evropian, e cila shpreh shqetësimin e saj në lidhje me procesin e CENSUS-it në Shqipëri, dhe ndikimet në këtë proces nga përfaqësi diplomatike për të reduktuar numrin e banorëve në disa zona, duke kërkuar ndërhyrjen dhe mbrojtjen e identitetit të pakicës maqedonase. Ky shqetësim i është adresuar disa organeve të administratës publike, ndër të cilët edhe Institutit të Statistikave.

Për qëllime të vlerësimit dhe adresimit të duhur të shqetësimeve të parashtruara nga subjekti "Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian", me tonat nr. K1/A20-5, datë 30.01.2024 dhe nr. K1/A20-7, datë 15.02.2024 kemi kërkuar të na informoni:

- *Cili është qëndrimi që ka mbajtur Instituti i Statistikave, pas administrimit të saj;*
- *Nëse nga të dhënat paraprake të administruara në rrugë elektronike, në kuadër të CENSUS-it të zhvilluar vitin e kaluar, rezulton të ketë të dhëna të cilat tregojnë për ndryshime në raportin e pakicave kombëtare bullgare dhe maqedonase, në frymën e pretendimeve të ngritura.*

Me tuajën nr. 320/1, datë 01.03.2024 na keni informuar në përgjithësi lidhur me ecurinë e CENS-it të popullsisë dhe banesave të zhvilluar në vitin 2023, si dhe mbi aktivitetet e planifikuara dhe kalendarin paraprak për shpërndarjen dhe publikimin e të dhënave të CENS, i cili parashikohet të lançohet në nivel kombëtar në muajin Qershor të vitit 2024.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, në situatën që parashtrohet është e rëndësishme të sigurohet transparencë e niveleve sa më të larta dhe nxitje e besueshmërisë kundrejt të dhënave të

administruara. INSTAT duhet të mbajë në qendrim të hapur, transparent dhe të përgjegjshëm ndaj publikut në përgjithësi, dhe komunitetit të pakicave kombëtare në vecanti, duke siguruar analizë konkrete, përfshirje aktive por edhe dialog të vazhdueshëm.

INSTAT ka një rol të rëndësishëm për të garantuar transparencën e nevojshme që do të sqaronte apo sheshonte të gjitha paqartësitë, pakënaqësitë, pretendimet apo edhe tensionet potenciale sa i takon identitetit të pakicave kombëtare. Për këtë arsye, duke qënë se INSTAT është ende në fazën e përpunimit të informacionit të mbledhura gjatë CENS, sugjerojmë të vlerësohen mundësitë për të kryer një analizë të detajuar, të pavarur dhe objektive të të dhënave të mbledhura, për të identifikuar ndryshime apo anomali në raportin e pakicave kombëtare bullgare dhe maqedonase, në frymën e pretendimeve të ngritura. Kjo analizë mund të përfshijë edhe konsultime me përfaqësues të këtyre grupeve të pakicave, për të dëgjuar shqetësimet e tyre, si dhe për të shpjeguar në detaje procesin e regjistrimit. Ky nivel transparence do të ndihmonte jo vetëm në qartësimin e pakënaqësive, por edhe në nxitjen e dialogut të përbashkët. Nëse ju e gjykoni të nevojshme, ne jemi të gatshëm të ndërmjetësojmë në këtë proces.

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, dhe në vijim të nenit 2 dhe nenit 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar,

### **SUGJEROJMË:**

**Instituti i Statistikave të publikojë të dhëna të plota dhe të detajuara sa i përket identitetit të pakicave kombëtare, duke identifikuar çdo ndryshim në raport me CENS-et e mëparshme, për të ndihmuar kuptueshmërinë e të dhënave dhe nxitur besimin nga publiku i gjerë**

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”, lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**K O M I S I O N E R E**

**Vilma SHURDHA**